Në bazë të nenit 48-b paragrafi (1) të Ligjit për Arsimin e Mesëm („Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë“ nr. 44/95, 24/96, 34/96, 35/97, 82/99, 29/02, 40/03, 42/03, 67/04, 55/05, 113/05, 35/06, 30/07, 49/07, 81/08, 92/08, 33/10, 116/10, 156/10, 18/11, 42/11, 51/11, 6/12, 100/12, 24/13, 41/14, 116/14, 135/14, 10/15, 98/15, 145/15, 30/16, 127/16, 67/17 dhe 64/18 dhe „Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut“ nr. 229/20, 78/25, 132/25 dhe 250/25), ministrja e Arsimit dhe Shkencës solli

UDHËZIME
për përmbajtjet e programuara nga shkolla në arsimin e mesëm profesional

I. DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1

Me këtë udhëzim përcaktohet qasja e unifikuar për planifikimin, hartimin, shqyrtimin profesional, organizimin, realizimin, rolet dhe përgjegjësitë, monitorimin, evaluimin, vlerësimin, evidencën dhe dokumentacionin e përmbajtjeve të programuara nga shkolla (në tekstin e mëtejmë: PPSh) në shkollat profesionale që realizojnë plane mësimore, në të cilat është paraparë fusha „Përmbajtje të programuara nga shkolla“.

Neni 2

PPSh kanë për qëllim të sigurojnë mundësi fleksibile për të mësuar, të cilat plotësojnë programet mësimore të detyrueshme dhe zgjedhore dhe mundësojnë zhvillimin e kompetencave shtesë, në përputhje me interesat, aftësitë dhe përcaktimet e nxënësve për karrierën, nevojat e komunitetit lokal dhe kërkesat e tregut të punës.

Përmes PPSH-së, nxënësve u mundësohet:

- zgjerimi dhe thellimi i njohurive, shkathtësive dhe kompetencave profesionale;
- përvetësimi i kompetencave të reja profesionale që lidhen me zhvillimin teknologjik dhe proceset bashkëkohore të punës;
- zhvillimin e kompetencave gjenerike, dixhitale, të gjelbra, STEM dhe sipërmarrëse që ndërlidhen me sektorin;
- njohja dhe zhvillimi i interesave, talenteve dhe potencialit të nxënësve;
- përvetësimi i përvojave praktike përmes bashkëpunimit me punëdhënësit dhe faktorët e tjerë relevantë;
- zhvillimi i përgjegjësisë shoqërore, komunikimit ndërkulturor dhe ndërgjegjësimit për zhvillimin e qëndrueshëm; dhe
- përgatitja më e mirë për punësim, vazhdimin e arsimit dhe të mësuarit e përjetshëm .

Neni 3

Planifikimi dhe realizimi i PPSH-së bazohen në parimet e vullnetarizmit, qasjes së barabartë, orientimit drejt nxënësit, relevancës, fleksibilitetit, sigurisë, partneritetit, gjithëpërfshirjes, transparencës dhe arsimit të bazuar në rezultatet e të mësuarit.

Neni 4

PPSH-ja plotësojnë programet mësimore të detyrueshme dhe zgjedhore dhe nuk mund të përdoren për përsëritjen e përmbajtjeve të parapara tashmë, kompensimin e orëve mësimore të parealizuara ose si zëvendësim për arsimin praktik, mësimin plotësues dhe mësimin shtesë.

II. PLANIFIKIMI I PPSH

Neni 5

Gjatë planifikimit të PPSH-së merren parasysh prioritetet zhvillimore të shkollës, interesat dhe nevojat e nxënësve, rekomandimet e punëdhënësve dhe faktorëve të tjerë relevantë, ndryshimet teknologjike në sektor, nevojat lokale dhe rajonale, si dhe kushtet në dispozicion për realizimin e tyre.

Neni 6

PPSH mund të përfshijnë një ose më shumë fusha të ndërlidhura të arsimit profesional, me qëllim të thellimit dhe zgjerimit të kompetencave profesionale në lidhje me:

- zbatimin e teknologjive digjitale, robotikës, automatizimit, inteligjencës artificiale, analizës së të dhënave dhe softuerëve të specializuar të sektorit;
- kompetencat e gjelbra, efikasitetin energjetik, burimet e ripërtëritshme të energjisë, ekonominë qarkore dhe mbrojtjen e mjedisit, të ndërlidhura me sektorin;
- STEM-in, aktivitetet laboratorike, inxhinierike, kërkimore dhe inovative, të ndërlidhura me sektorin dhe kualifikimin arsimor;
- sipërmarrjen, shkrim-leximin afarist dhe financiar, si dhe zhvillimin e karrierës në kontekstin e sektorit;
-komunikimin, punën ekipore, të menduarit kritik, kreativitetin, udhëheqjen dhe etikën profesionale; dhe
-aktivitetet praktike, projektuese, në terren, vullnetare dhe aktivitete të tjera arsimore.

Neni 7

Programin për PPSH-në mund ta hartojë shkolla profesionale ose Qendra për Zhvillimin e Arsimit Profesional (në tekstin e mëtejmë: QZHAP).

Në përcaktimin e nevojave dhe në hartimin e programit për PPSH-në nga ana e shkollës mund të marrin pjesë mësimdhënësit, nxënësit, prindërit, punëdhënësit, përfaqësuesit e vetëqeverisjes lokale dhe faktorë të tjerë relevantë.

Kur konstatohet nevoja për përmbajtje me interes të përbashkët për disa shkolla, sektorë ose kualifikime arsimore, QZHAP-ja mund të hartojë program për PPSH-në ose të formojë grup punues për hartimin e tij, në përputhje me aktet e brendshme të QZHAP-së për hartimin e programeve mësimore.

Neni 8

Programet për PPSh të hartuara nga QZHAP-ja i sjellë drejtori i QZHAP-së dhe publikohen në faqen e internetit të QZHAP-së.

Shkollat mund t'i përdorin drejtpërdrejt programet e përmendura në paragrafin 1 të këtij neni, pa marrë mendim shtesë nga ekspertët dhe të organizojnë në mënyrë të pavarur zbatimin e tyre në përputhje me këto udhëzime.

Neni 9

Programi për PPSH-në hartohet në përputhje me formularin e dhënë në Shtojcën 1 dhe përmban së paku: emërtimin, sektorin, kualifikimin arsimor, vitin e arsimit, fondin e orëve mësimore, qëllimet e programit, njësitë modulare, rezultatet e të mësuarit, përmbajtjet dhe termat, aktivitetet dhe metodat, standardet e vlerësimit, kushtet materiale-teknike dhe hapësinore, normativin për kuadrin mësimor dhe mënyrën e vlerësimit.

Neni 10

Fondi i përgjithshëm i orëve mësimore për PPSH-në përcaktohet brenda fondit të paraparë në planin mësimor.

Neni 11

Çdo program planifikohet për një vit të përcaktuar të arsimit. Në varësi të përmbajtjes, programi mund të jetë i dedikuar për nxënësit e të njëjtit kualifikim arsimor ose për nxënësit e kualifikimeve arsimore dhe sektorëve të ndryshëm.

III. ORGANIZIMI DHE REALIZIMI I PPSH-së

Neni 12

Shkolla ia dorëzon QZHAP-së propozim-programin për PPSH-në, së bashku me një shkresë zyrtare dhe kërkesë për mendim profesional, më së voni deri më 15 qershor të vitit aktual, për vitin e ardhshëm shkollor në të cilin planifikohet realizimi i tij.

Propozim-programi dorëzohet në dy kopje të shtypura dhe në formë elektronike.

Neni 13

Nga ana e QZHAP-së shqyrtohet propozim-programi për PPSH dhe hartohet mendim profesional brenda afatit prej 10 ditësh pune nga dita e pranimit të tij.

Mendimi profesional bazohet në plotësimin e kritereve në vazhdim:
- Përmbajtja e programit është në përputhje me qëllimet e PPSH-së;
- Rezultatet e të mësuarit dhe përmbajtjet janë të përshtatshme për sektorin dhe kualifikimin arsimor;

- Rezultatet e të mësuarit janë të përshtatshme për vitin e shkollimit;
- Programi është hartuar në përputhje me formularin dhe kërkesat metodologjike; dhe
- Shkolla disponon kushte përkatëse kadrovike, hapësinore, materiale-teknike dhe të sigurisë.

Neni 14

Nëse propozim-programi për PPSH i plotëson kriteret e përcaktuaraQZHAP jep mendim profesional pozitiv për të.

Numri i protokollit dhe data e mendimit profesional pozitiv të QZHAP-së shënohen në programin për PPSH, i cili i dorëzohet shkollës në formë elektronike ose në formë të shtypur.

Neni 15

Nëse propozim-programi për PPSH nuk i plotëson kriteret e përcaktuara, nga ana e QZHAP dorëzohet mendim profesional me vërejtje dhe rekomandime për përmirësimin dhe plotësimin e tij.

Programi nuk mund të realizohet derisa të marrë mendim profesional pozitiv, në përputhje me nenin 14, paragrafin 1 të këtij udhëzimi.

Neni 16

Programi për PPSH mund të realizohet për periudhë prej maksimumi pesë vitesh shkollore.

Neni 17

Nga ana e shkollës formohet grupi/grupet me nxënës të të njëjtit vit shkollimi, të cilët kanë shprehur interes për ndjekjen e programit për PPSH.

Nxënësi/nxënësit që kanë shprehur interes për programin e konfirmojnë këtë në Formularin e dhënë si Shtojca 2, i cili është pjesë përbërëse e këtij udhëzimi.

Numri i përgjithshëm i grupeve të formuara për realizimin e programeve për PPSH gjatë një viti shkollor nuk mund të jetë më i madh se numri i paraleleve të formuara në vitin përkatës të shkollimit në arsimin e mesëm profesional.

Neni 18

Programi për PPSH fillon të realizohet me fillimin e vitit shkollor.

Neni 19

Koha dhe vendi i realizimit përcaktohen me orarin e orëve mësimore për vitin shkollor përkatës.

Neni 20

PPSH realizohen në përputhje me qëllimet e programit dhe rezultatet e të mësuarit , interesat e nxënësve dhe kushtet në dispozicion.

Programet për PPSH mund të realizohen në shkollë, në kompani dhe subjekte të tjera afariste, në institucione dhe ente publike, në komunitetin lokal, nëpërmjet mësimit në terren, punës praktike dhe mentorimit, punëtorive, demonstrimeve, vizitave studimore, aktiviteteve hulumtuese, të mësuarit të bazuar në probleme dhe projekte, si dhe nëpërmjet realizimit të kombinuar, të drejtpërdrejtë dhe digjital.

Neni 21

Kur programi për PPSH realizohet jashtë shkollës, shkolla dhe organizata partnere përcaktojnë vendin dhe kohën e realizimit, personat përgjegjës, detyrimet e palëve, mënyrën e mbikëqyrjes së nxënësve dhe masat për sigurinë dhe shëndetin gjatë punës, në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi dhe aktet e brendshme.

Neni 22

Shkolla mund të bashkëpunojë me punëdhënësit, odat ekonomike, vetëqeverisjen lokale, institucionet publike, institucionet e arsimit të lartë dhe institucionet shkencore-hulumtuese, qendrat e trajnimit, organizatat profesionale dhe qytetare, organizatat ndërkombëtare dhe palët e tjera relevante në përcaktimin e nevojave, propozimin e temave, hartimin dhe realizimin e aktiviteteve, sigurimin e mentorëve, profesionist profesional, pajisjeve dhe materialeve, ligjëratave të ftuara, projekteve, hulumtimeve, punës praktike dhe vlerësimin e produkteve të nxënësve.

IV. ROLET DHE PËRGJEGJËSITË

Neni 23

Drejtori i shkollës është përgjegjës për identifikimin e nevojave, propozimin dhe hartimin e programit, formimin e grupit/eve, përzgjedhjen e mësimdhënësit/mësimdhënësve, sigurimin e kushteve, koordinimin me partnerët, sigurinë e nxënësve, monitorimin e realizimit dhe udhëheqjen e dokumentacionit.

Neni 24

Drejtori siguron mbështetjen organizative, kadrovike, hapësinore dhe materiale-teknike, miraton orarin, cakton personat përgjegjës dhe siguron që realizimi të jetë në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi dhe aktet e brendshme të shkollës.

Neni 25

Mësimdhënësi planifikon dhe realizon programin, përgatit orarin, i informon nxënësit për qëllimet e PPSH, detyrimet dhe kriteret e vlerësimit, siguron një mjedis të sigurt dhe gjithëpërfshirës, monitoron vijueshmërinë dhe përparimin, vlerëson arritjet dhe mban evidencën e nevojshme.

Neni 26

Nxënësi merr pjesë rregullisht në aktivitete, respekton orarin, rregullat e sigurisë dhe detyrimet e dakorduara, i kryen detyrat dhe merr pjesë në procesin e vetëvlerësimit dhe evaluimit të programit.

Neni 27

Organizata partnere siguron kushtet e dakorduara, profesionist profesional, pajisjet dhe masat e sigurisë, respekton rregullat për mbrojtjen e nxënësve dhe bashkëpunon me shkollën në monitorimin e aktiviteteve dhe rezultateve të arritura.

Neni 28

QZHAP harton dhe publikon programe me interes të përbashkët, jep mendime profesionale për programet e hartuara nga shkollat, siguron udhëzime profesionale dhe sipas nevojës, monitoron zbatimin e këtij udhëzimi.

V. MONITORIMI, EVALUIMI DHE VLERËSIMI

Neni 29

Shkolla e ndjek në mënyrë të vazhdueshme realizimin e programit, vijueshmërinë dhe pjesëmarrjen e nxënësve, realizimin e fondit të planifikuar të orëve mësimore, zbatimin e aktiviteteve të planifikuara dhe kushtet për realizimin e programit.

Monitorimin e kryejnë mësimdhënësi, drejtori ose personi i autorizuar prej tij, si dhe, sipas nevojës, persona të tjerë profesionalë.

Neni 30

Arritjet e nxënësit vlerësohen në bazë të rezultateve të mësuarit dhe standardeve të vlerësimit të përcaktuara në program, duke zbatuar metoda, instrumente dhe dëshmi përkatëse.

Si dëshmi mund të përdoren punimet praktike, detyrat projektuese dhe hulumtuese, prezantimet, raportet, demonstrimet, produktet digjitale, portofoli, vëzhgimi i punës praktike dhe dëshmi të tjera përkatëse .

Arritjet shprehen me notë numerike, e cila evidentohet në dokumentacionin dhe evidencën pedagogjike, në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi për vlerësimin në arsimin e mesëm. Nota nuk llogaritet në suksesin e përgjithshëm të nxënësit.

Neni 31

Pas përfundimit të programit për PPPSH, shkolla kryen evaluimin e relevancës, cilësisë, organizimit, rezultateve të arritura dhe kënaqësinë e nxënësve dhe partnerëve të tij.

Në kuadër të evaluimit mund të përdoren pyetësorë, intervista, diskutime, analiza e pjesëmarrjes, produkteve të nxënësve, rezultateve të arritura dhe informacioneve kthyese nga mësimdhënësit dhe partnerët.

Gjetjet përdoren për përmirësimin, vazhdimin, ndryshimin ose ndërprerjen e programit.

Neni 32

Evidenca mbahet në formë elektronike, ndërsa përmbajtjet mësimore evidentohen në Ditarin Elektronik.

Neni 33

Gjatë grumbullimit, përdorimit dhe ruajtjes së fotografive, videoincizimeve, produkteve digjitale dhe materialeve të tjera që përmbajnë të dhëna personale, respektohen dispozitat ligjore në fushën e mbrojtjes së të dhënave personale.

Neni 34

Ky udhëzim hyn në fuqi ditën e nesërme nga dita e sjjelljes së tij dhe do të fillojë të zbatohet nga viti shkollor 2027/2028..

Nr. 13-13465/1
Viti 28.10.2026

Министерка за образование и наука,
проф. д-р Весна Јаневска, с.р.

Shkupi

Shtojca 1

Formulari për hartimin e programit për përmbajtjet e planifikuara nga shkolla

EMRI I SHKOLLËS SË MESME PROFESIONALE ME EMBLEMËN/LOGON E SHKOLLËS

EMËRTIMI I PROGRAMIT PËR PËRMBAJTJET E PLANIFIKUARA NGA SHKOLLA

E dizajnuar në mënyrë modulare

për vitin e _____ (_____) të arsimit
(me numra romakë dhe me shkronja)1

_____
Kualifikimi arsimor

_____
Sektori

Vendi ,viti, _____

Emërtimi i programit për përmbajtjet e planifikuara nga shkolla	
Sektori	
Emërtimi i kualifikimit/eve arsimor/e	

Viti i shkollimit	
Numri i orëve javore/vjetore për realizimin e programit	
Qëllimet e programit	
Njësitë modulare të programit	**1.** **2.** **3.**
Kushtet materiale-teknike dhe hapësinore	
Normativi për kuadrin mësimor	Programin për përmbajtjet e planifikuara nga shkolla_____ e realizojnë mësimdhënësit që kanë përfunduar studimet në:

Numri Rend.	**Njësia modulare 1: _____**			
	Rezultatet nga mësimi	**Përmbajtjet dhe termat**	**Aktivitetet dhe metodat**	**Standardet e vlerësimit**
1	**Nxënësi/Nxënësja dhe do të jetë i/e aftë të:**		Aktivitetet: Metodat:	**Nxënësi/Nxënësja mundet të :**

Numri Rend.	Njësia modulare 1: _____			
	Rezultatet nga mësimi	**Përmbajtjet dhe termat**	**Aktivitetet dhe metodat**	**Standardet e vlerësimit**
2			Aktivitetet: Metodat:	

Numri rend.	Njësia modulare 1: _____			
	Rezultatet nga mësimi	**Përmbajtjet dhe termat**	**Aktivitetet dhe metodat**	**Standardet e vlerësimit**
1	**Nxënësi/Nxënësja Do të jetë në gjendje /në po:**		Aktivitetet: Metodat:	**Nxënësi/Nxënësja mundet të :**
2			Aktivitetet: Metodat:	

Vlerësimi i arritjeve të nxënësve.	
Fillimi i zbatimit të programit	Viti shkollor 20__/20__
Institucioni përgjegjës për miratimin e programit / dhënien e mendimit	Qendra për Zhvillimin e Arsimit Profesional.
Bartësi i programit	
Numri dhe data e mendimit pozitiv të marrë	**Nr. _____** **Data _____**

Shtojca 2

Përzgjedhja e programit për përmbajtjet e programuara nga shkolla

Shkolla e mesme komunale / Shkolla e Qytetit të Shkupit / SHSHM–QRAAP
_____
Vendi
_____

Të dhënat për nxënësin :

Emri, emri i babait dhe mbiemri i nxënësit/nxënëses _____, paralelja ____,
Sektori _____,
Kualifikimi arsimor_____.

Emërtimi i programit të përzgjedhur **për përmbajtjet e programuara nga shkolla (PPSh)** _____, në vitin shkollor _____/____

Nënshkrimi i nxënësit , **Data,**

_____ **_____**